

Njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria Aksionare "Telekom Srbija", Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll mbi kapitalin themelor të Shoqërisë Tregtare MOST NET ISP SHPK Lubovija

(lënda nr. 08-161/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 14.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria Aksionare "Telekom Srbija", Beograd, me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi kapitalin themelor të Shoqërisë Tregtare MOST NET ISP SHPK Lubovija, me seli të regjistruar në rrugën Vojvode Mishiqi 41, Lubovija, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Shoqëria Aksionare "Telekom Srbija", Beograd, është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, i regjistruar për telekomunikime kabllore dhe para së gjithash shërbime për telefoni fikse dhe celulare, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Shoqëria Aksionare "Telekom Srbija" Beograd ka person të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, edhe atë:

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, e regjistruar për veprimtarinë: telekomunikime me tela, respektivisht për ofrimin e shërbimeve vijuese: rrjet publik radio-komunikues, qasje në internet me brez të gjerë, shërbime ndër operatoresh, shërbime telefonike publike në rrjetin publik të komunikimit celular, ri-transmetim të shërbimeve programore televizive, satelit.

Person i lidhur i MTEL SHPKNJP Shkup është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup punon në tregun për ofrimin e shërbimeve celulare të komunikimit elektronik (shërbimi me parapagesë/prepaid) dhe nuk u ofron shfrytëzuesve të saj përfundimtarë shërbim celular postpaid. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup është operator i rrjetit celular virtual (ORRCV) në tregun maqedonas për komunikime elektronike dhe ofron shërbime zanore kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming, SMS dhe internet.

Gjithashtu, person i lidhur i Shoqërisë Aksionare "Telekom Srbija" Beograd në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, e regjistruar për veprimtarinë telekomunikime satelitore.

Shoqëria MOST NET ISP SHPK Lubovija është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, në momentin e parashtrimit të Njoftimit, i regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbimeve të internetit.

Shoqëria MOST NET ISP SHPK Lubovija nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, tregjet përkatëse janë tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse në internet me brez të gjerë, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditëve nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

20.11.2025

Shkup